



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



**Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin mars 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit mars 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Shoqata “Nucleus Albania”, në 5-vjetorin e themelimit të saj, mblodhi bashkë sipërmarrje të vogla dhe të mesme ku diskutimi u fokusua në drejtim të mbështetjes dhe zhvillimit të tyre më të mirë. Rreth 1000 sipërmarrës janë pjesë e kësaj shoqate, e cila ka krijuar 82 “bërthama” funksionale që ndërlidhin sektorë të ndryshëm me qëllim rritjen e këtyre kompanive.

Tryeza e diskutimit midis Ministrisë së Infrastrukturës, ERE-s, OSHEE-s dhe Shoqatës së Prodhuesve ishte një mundësi mjaft e mirë për të biseduar rreth kushteve aktuale të tregut të energjisë elektrike, mundësive dhe rendësisë së liberalizimit të tij në vendin tonë.

Muaji mars krijoi një situatë jo të mirë në vend por edhe në mbarë botën, për shkak të përhapjes së virusit COVID-19. Në kuadër të kësaj situatë dhe duke përqaftuar ura të reja të komunikimit digjital, kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me sipërmarrjen në vend duke analizuar të gjitha masat në dobi të mbrojtjes së shëndetit dhe parandalimit të përhapjes së virusit, si qëllimi ynë kryesor, por gjithashtu duke u përpjekur në lehtësimin e vazhdimin të aktivitetit të tyre në këto kushte të vështira.


Jo vetëm kemi analizuar një numër të madh shkresash, ankesash dhe kërkesash të ardhura nga sipërmarrja, por edhe kemi organizuar takime online me përfaqësues të

shoqatave dhe dhomave të tregtisë me qëllim adresimin e problematikave të bizneseve. Gjatë këtyre takimeve online, kemi kuptuar problematikat e hasura nga sektorë të ndryshëm të sipërmarrjes, si dhe kemi lehtësuar zgjidhjen e tyre me institucionet respektive.

Dizejnim i paketës së parë ekonomike, ishte hapi i parë në ndihmë të bizneseve dhe punonjësve me qëllim përballimin e situatës së rënduar të krijuar në vend, situatë e cila kërkon vigjilencë maksimale por edhe hapa që ndërmerren në kohën e duhur dhe në përputhje me mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e COVID-19.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.


Me konsideratën më të lartë,
Eduard Shalsi




Analiza e Ankesave Mars 2020

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimit të formatit të raportimit dhe të krijimit të rrjetit të koordinatorëve, dëshirojmë t'ju paraqesim disa grafikë në lidhje me ankesat për muajin mars që vijojnë si më poshtë.


1. Shpërndarja e ankesave në baza javore



2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë.

